



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. dhe 1.5., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, më datën 09.08.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

| | |
|--------------|-------------------|
| Dep. | Nr. Prot. |
| Dep. | Br. Prot. |
| Dep. 06 | Prot. No. 1531/23 |
| Nr. Faq. | Data |
| Br. Str. | Datum |
| Nr. Page. 02 | Date 09.08.2023 |

Mbyllet rasti me nr. APK-DPKI-06-015/23, për zyrtaren e lartë Arbëresha Nela - Turjaka, Anëtare e Këshillit Drejtues në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të kërkesës nga jashtë (raportues i rastit), ka filluar procedurën e hetimit administrativ për shqyrtimin e konfliktit të interesit, lidhur me pretendimet si në vijim;

“Arbëresha Nela - Turjaka, është Anëtare e Këshillit Drejtues në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Anëtare e Këshillit Drejtues të Odes së Mjekëve të Kosovës, Kryesuese e Këshillit Kosovar për udhërrëfyes dhe Protokolle, Mjeke e Licencuar, Mësimdhënëse në Kolegjin AAB, Udhëheqëse e Departamentit/ Divizionit në Ministrinë e Shëndetësisë, znj. Nela – Turjaka është bashkëshorte e B.T, profesor në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, e ka njoftuar zyrtaren e lartë me shkresë njoftuese për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pastaj është njoftuar me pretendimet e ngritura për konflikt interesi.

Zyrtarja e lartë Arbëresha Nela – Turjaka, ka ushtruar funksionin si Udhëheqëse e Divizionit për Planifikim Strategjik në Ministrinë e Shëndetësisë nga data 15.01.2015.

Me vendimin nr.110/III/2022 të datës 02.03.2022 është caktuar zëvendësuese e Drejtorit të Departamentit për Zhvillim Strategjik Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë.

Zyrtarja e lartë Nela Turjaka, me vendimin nr. 257/VI/2021 të datës 15.06.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë është emëruar Anëtare e Këshillit Drejtues të Odes së Mjekëve të Kosovës si



përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe me Vendimin nr.219/IV/2021 të datës 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë është emëruar Kryesuese e Këshillit Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike.

Në pozitën e Anëtares së Këshillit Drejtues në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", është emëruar nga Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me vendimin nr. 01B/287 të datës 17.09.2021.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se;

Arbëresha Nela – Turjaka, nuk e ushtron pozitën Udhëheqëse e Divizionit për Planifikim Strategjik në Ministrinë e Shëndetësisë sepse me datë 29.07.2022 ka ofruar dorëheqje nga kjo pozitë. Lidhur me këtë Ministria e Shëndetësisë ka nxjerr vendimin me nr.02/VIII/22 për lirim nga detyra.

Zyrtarja e lartë Nela -Turjaka, duke qenë e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, ka përfaqësuar institucionin punëdhënës në Oden e Mjekëve të Kosovës si dhe në Këshillin Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike. Me rastin e dorëheqjes nga funksioni si Udhëheqëse e Divizionit për Planifikim Strategjik në Ministrinë e Shëndetësisë siç ka deklaruar zyrtarja e lartë përmes shkresës 1284-1/23, është ndërprerë ushtrimi i këtyre detyrave të deleguara.

Me rastin e emërimit në pozitën e Anëtares së Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", zyrtarja e lartë me datë 20.09.2021 ka njoftuar Kolegjin lidhur me ndërprerjen e angazhimit si Mësimdhënëse në Kolegjin AAB.

Lidhur me pretendimin se; zyrtarja e lartë është Mjeko e licencuar, kjo situatë nuk paraqet konflikt të interesit për arsye se Ligji nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk ka përcaktuar ndonjë dispozitë kufizuese që do të mund ti referohemi për rastin konkret.

Sa i përket pretendimit se; Arbëresha Nela – Turjaka, është bashkëshorte e B.T – profesor në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit situata e tillë nuk paraqet konflikt interesi.

Andaj, nga sa u tha më lartë, për pretendimet e ngritura nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit
